

CO de La Tour-de-Trême 2026-2027

PRINDËRVE TË NXËNËSVE TË KLASËS 10^H dhe 11^H

Mbledhje me prindërit: e hënë 27.10.2025:

19h30 - 20h45

Të dashur Prindër,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Vitet e fundit të CO-së janë etapa vendimtare për përgatitjen e projektit profesional ose shkollor pas ciklit të orientimit. Në klasën 10H veçanërisht, ju dhe fëmija juaj duhet të njiheni me rrugët e formimit pas CO-së, ta shoqëroni fëmijën tuaj në zbulimin e botës profesionale dhe të hyni në një reflektim mbi këtë çështje. Në klasën 11H, është më shumë se kurrë momenti për të nisur, nëse kjo nuk është bërë tashmë, hapat për botën pas shkollimit.

Për t'ju informuar plotësisht dhe për t'ju ndihmuar në mbështetjen që mund t'i jepni fëmijës suaj, kemi kënaqësinë t'ju ftojme të merrni pjesë në mbrëmjen e prindërve që do t'i kushtohet **orientimit profesional dhe rrugëve të formimit profesional**.

Me këtë rast, shërbimi i orientimit profesional (SOPFA) dhe shkollat profesionale do t'ju paraqesin informacionet e rëndësishme dhe sfidat që lidhen me orientimin dhe rrugët e formimit profesional.

Programi:
<i>Pritja</i> Z. Jérôme Maradan, Drejtor i CO-së
<i>Orientimi profesional në CO</i> Znj. Eva Morgenegg, Këshilltare orientimi
<i>Rrugët e formimit profesional pas CO-së</i> Znj. Léonie Sudan, Drejtoreshë e EPAC-ut.
<i>Shkëmbim / Diskutim</i>

Vendi dhe data:
E hënë, më 27 tetor 2025, në orën 19h30
Cikli i orientimit i La Tour-de-Trême
Salla CO2

Vëmendje: rreth datës 10 shtator keni marrë me postë një broshurë të titulluar «Manifestations et tests d'aptitude», e cila përmban të gjitha datat e seancave të

ndryshme informuese kantonale. Megjithatë, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj mbi dy seanca:

Viti i dymbëdhjetë gjuhësor (Douzième linguistique)

- E hënë, më 3 nëntor 2025, në orën 19h30, në CO du Gibloux në Farvagny (në frëngjisht)

Collège du Sud, ECG dhe Shkolla e tregtisë

- E hënë, më 24 nëntor 2025, në orën 19h30, në CO-në e Bulle-it (aula)

Për më tepër, CO-ja e La Tour-de-Trême organizon në ambientet e veta, në bashkëpunim me SOPFA-n:

- E shtunë, 8 nëntor 2025, **Beruf-Infos-Métiers**, 08h30-11h30
- E shtunë, 21 mars 2026, **Job Dating**, 09h00-12h00

Nga ana tjetër, lejohe mi t'ju kujtojmë ekzistencën e platformës zvicerane: **www.orientation.ch**, referencë në fushën e orientimit profesional dhe të kërkimit të praktikave ose të vendeve të mësimi t profesional.

Së fundi, **Znj. Morgenegg**, Këshilltarja jonë e orientimit, qëndron në dispozicion të nxënësve (dhe të prindërve të tyre) për një ndjekje më të personalizuar, nëse kjo do të rezultonte e nevojshme.

Mund t'ju sigurojmë se bëjmë gjithçka për ta shoqëruar fëmijën tuaj drejt botës pas shkollimit, cilado qoftë ajo; megjithatë, kemi natyrisht nevojë për angazhimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj, dhe pikërisht për këtë gëzohemi që do t'ju takojmë më 27 tetor ose në një nga ngjarjet e tjera, nëse kjo mund t'i vlejë fëmijës suaj.

Me përshëndetjet e mia më të përzemërta,

Jérôme Maradan
Drejtör
CO La Tour-de-Trême